

# **STATUTI**

## **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR "TOSKAJ 2007" SH.P.K**

### **KREU 1**

#### **Themelimi , Forma, Emri, Kohëzgjatja, Objekti dhe Selia**

#### **THEMELIMI I SHOQËRISË**

##### **NENI 1**

Duke u bazuar në ligjin nr 9901 date 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe në ligjin nr 9723 date 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Regjistrimit", unë Afrim Tsokaj i biri Lac-it i datëlindjes 16.02.1972, banues në Shtoj i Vjetër , Shkoder nën vullnetin tim të lire sot me date 24.02.2016 nënshkruaj miratimin e statutit të shoqërisë **"TOSKAJ 2007" sh.p.k .**

#### **FORMA E SHOQËRISË**

##### **NENI 2**

Kjo Shoqëri do të jetë "Shoqëri Tregtare" e formës "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (sh.p.k)" TOSKAJ 2007 "sh.p.k. Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe atë civil, doganor, tatimor, fiskal dhe akte të tjera ligjore mbi bazën e aktit të themelimit dhe statutit të saj dhe normat e të drejtës ndërkombëtare .

#### **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

##### **NENI 3**

Kohëzgjatja e kësaj shoqërie do të jetë pa afat duke filluar nga dita e regjistrimit në Q.K.R për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

#### **EMËRTIMI TREGTAR I SHOQËRISË**

Kjo shoqëri do të quhet "TOSKAJ 2007 "sh.p.k dhe vula e saj ka formën rrethore në të cilën do shkruhet "TOSKAJ 2007 "sh.p.k".



## **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

### **NENI 4**

**Objekti i veprimtarisë ekonomike të kësaj shoqërie është :**

- ❖ Tregti me shimicë e pakicë, import-eksport artikuj të ndryshëm, industrialë, ushqimorë, materiale ndërtimi, elektroshtëpiake, lëndë drusore, punime ndërtimi.

## **SELIA E SHOQËRISË**

### **NENI 5**

**Kjo shoqëri do ketë selinë e vet në adresën Shtoj i Vjetër, Lagjja Sumjane, Rruga Shtoj i Vjeter, godine 1-kateshe, nr 60**

## **KREU 2**

**Kapitali Themeltar, Organet e Shoqërisë , Administratori ,Eksperti Kontabël dhe Prishja e Shoqërisë**

## **KAPITALI THEMELTAR**

### **NENI 6**

Shuma e kapitalit themeltar të kësaj shoqërie është 100,000 ALL (njëqind mijë Lek) me 1 kuotë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin shoqërisë është si më poshtë:

1. Ortaku themelues Afrim Lac Toskaj.

Shoqëria çel llogari bankare në monedhën vendase (lek) si dhe çdo lloj valute tjetër nëbanka vendase ose të huaja, private apo shtetërore me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiarë të aktivitetit të saj.

Ortakët dhe administratori të caktuar nga shoqëria depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në bankat ku është çelur llogaria.



2

## NENI 7

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave te kodit civil dhe atij tregtar.

Asambleja e ortakëve ka te drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht oase tërësisht kontributet e saj përfshirë edhe fondet e kontributet në natyrë.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të jenë të vërtetuara me akt noterial dhe për një gjë të tillë asambleja e përgjithshme duhet të marrë paraprakisht vendim me shkrim.

## NENI 8

Kapitali themeltar i shoqërisë mund te rritet ose të zvogëlohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme, vendim i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet ne regjistrin përkatës.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme shoqëria ka të drejtën që një pjesë të kuotave të kapitalit themeltar t'ia tjetërsojë një apo disa personave fizikë jashtë shoqërisë ose personave juridik, vendas apo të huaj mbi bazën e Aktit noterial te tjetërsuar .

Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme për ndryshim të kapitalit themeltar i dërgohet menjëherë QKR-së.

## NENI 9

Kapitali nuk mund te jetë kurrë i përfaqesuar me letra me vlerë dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet para kërkesës së drejtuar në QKR për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.


Pjesët e kapitalit mund të transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht .

## ORGANET E SHOQËRISË

### NENI 10

Asamblea e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues dhe vendimor i shoqërisë dha ajo ushtron te gjitha kompetencat që ligji "Për shoqëritë tregtare: i njeh asamblesë së ortakëve.

Asamblea e përgjithshme mund t'ja delegojë kompentencat një ose shumë administratoreve caktuar prej saj dhe nje personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërië vetëm mbi bazën e prokurës.

A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and a vertical line, positioned in the bottom right corner of the page.

## NENI 11

Me vendim të Asamblesë shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë shtetas shqiptarë apo të huaj ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda dhe jashtë vendit.

Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë vendos:

- ❖ Mbi ndryshimet në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë
- ❖ Mbi formimin e filialeve degëve dhe përfaqësive jashtë vendit
- ❖ Mbi rritjen apo zvogëlimin e kapitalit themelitar
- ❖ Mbi ndryshimet në objekt dhe mbi blerjen e pjesëve të kapitalit në shoqëri të tjera
- ❖ Mbi transferimin dhe revokimin e likuidatorëve
- ❖ Mbi mënyrën e operimit me mjetet financiare monetare
- ❖ Mbi emërimin dhe shkarkimin e Administratorit

## NENI 12

Kjo shoqëri administrohet nga administratorët z.Afrim Toska, i cili emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë ndryshimi me konsensusin e ortakëve.

## EKSPERTI KONTABËL

### NENI 13


Veprimet ekonomike financiare të shoqërisë mbyllen me datë 31 dhjetor të çdo viti. Për nxjerrjen e rezultatit kontabël mbi bazën e aktivitetit dhe pasivitetit ngarkohet nga asambleja e përgjithshme një ekspert kontabël i autorizuar.

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë akt gjithvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë nga ana e asamblesë..

Në perfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit me shkrim, nxjerrjen rezultatit të bilancit vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara e cila është e detyruar t'ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

### NENI 14

Nxjerrja e rezultateve të bilancit vjetor duhet bërë me saktësi duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen nga ligji për kontabilitetin dhe atyre të sistemit të taksave që janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo subjekt privat që ushtron veprimtarë tregtare.



## **NENI 15**

Bilanci kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asmablesë së Përgjithshme e cila jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj duke patur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

## **NENI 16**

Të ardhurat neto (dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mesipërme dhe të atyre për shlyrjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi ortakëve të shoqërisë sado qofshin ato.

## **PRISHJA E SHOQËRISË**

### **NENI 17**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkakut edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar siç mund të jenë, Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj një nga mënyrat e parashikuara nga ligji "Për falimentimin"

Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këto raste Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një ose disa likuidatore dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij dhe emertesën "Shoqëri në likuidim e sipër".

### **NENI 18**

Afati i emërimit të likuidatorit publikohet sipas kushteve që parashtron ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentet që duhen depozituar në aneksin e regjistrimit në QKR.

### **NENI 19**

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet vendimeve plotësuese dhe të ligjshme, dhënë nga Asambleja e Përgjithshme si dhe legjislativi në fuqi.

## **ORTAKET E SHOQËRISË**

**AFRIM TOSKAJ**

